
© 2023 ZENELAJ, E; HAWA, A; DURMISHI, E. & Buletini Shkencor Reald.

This is an open access article licensed under the [Creative Commons Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/)

Peer review method: Blind review

Review Article - case study

DOI: 10.59858/BSHR100053

Received:01.11.2023, Accepted: 07.12.2023, Published: 15.12.2023


Cito: Zenelaj, E.; Hawa, S.; Durmishi, E.; (2023) “ Sfidat e universiteteve për kërkimin shkencor në ballkanin perëndimor ”, Buletini Shkencor Reald ,Vol 8(2), pp.56–68. 10.59858/BSHR100053

SFIDAT E UNIVERSITETEVE PËR KËRKIMIN SHKENCOR NË BALLKANIN PERËNDIMOR¹

Dr. Engjëllushe ZENELAJ¹, Dokt.Suada HAWA², Dr. Ermelinda DURMISHI³

¹ Reald University College, Vlorë, Albania  <https://orcid.org/0000-0002-1653-6534>  enxhizenelaj@gmail.com

² Ministry of Education and Sports, Albania  <https://orcid.org/0009-0008-1909-1826>,  suadahawa@gmail.com

³ Ministry of Education and Sports, Albania,  ermelinda.durmishi@arsimi.gov.al

Abstrakt

Ky artikull ka për qëllim të shqyrtojë dhe të analizojë sfidat në kërkimin shkencor në universitetet e Ballkanit Perëndimor. Analiza përqendrohet në identifikimin e problematikave kryesore që ndikojnë në nivelin e kualitetit të kërkimit shkencor në këto universitete duke sjellë në fokus vështirësitë financiare, standardet e ulëta të proscit mësimit, dhe mungesën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve.

Nëpërmjet një analize të përditësuar, identifikohen faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto sfida. Një vëmendje e posaçme i kushtohet ndikimit të kushteve financiare në zhvillimin e kërkimit shkencor, si dhe mungesës së standardeve të larta akademike. Ky artikull gjatë trajtimit të kësaj teme përfshin edhe sugjerime konkrete për të përmirësuar situatën, duke përfshirë hapa të mundshëm për të rritur bashkëpunimin ndërmjet universiteteve dhe për të avancuar standardet e kërkimit shkencor në rajon.

¹ Prezantuar ne sesionin shkencor te projektit “STANDARDS OF SCIENTIFIC WRITING AND INDEXING OF SCIENTIFIC JOURNALS BY IMPACT FACTOR”, me mbështetjen financiare nga Western Balkan Fund-Individual Move Grants

Kjo analizë synon të jetë një kontribut për të adresuar sfidat që ballafaqohen universitetet e Ballkanit Perëndimor në fushën e kërkimit shkencor dhe të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës aktuale.

Fjalët kyçe: *kërkim shkencor, universitet, zhvillim, sfida, ballkani perëndimor*

I. HYRJE

Megjithë progresin e shënuar gjatë viteve të fundit në Ballkanin Perëndimor, institucionet e arsimit të lartë vazhdojnë të kenë ende sfida dhe vështirësi përballë tyre.

Në Ballkanin Perëndimor shpesh herë tensionet politike, tensionet historike, si dhe mungesa e platformave të përbashkëta për shkëmbimin e ideve dhe bashkëpunimin shkencor janë disa indikatorë të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm të pasqyruar edhe midis universiteteve. Kjo mund të ketë si pasojë mungesën e projekteve të përbashkëta, nivelin e ulët në shkëmbimin e ekspertizës dhe ideve, që ndikon në nivelin e përgjithshëm të cilësisë së kërkimit shkencor.

Gjithashtu konstatohet se botimet shkencore të universiteteve shpesh janë larg standardeve ndërkombëtare të indeksimit të publikimeve shkencore. Një nga arsytet mund të jetë mungesa e burimeve dhe infrastrukturës për të kryer hulumtime të mëtejshme dhe për të përmirësuar cilësinë e punimeve shkencore. Financimi i kufizuar dhe mungesa e teknologjisë së nevojshme për hulumtim mund të ndikojnë në pamundësinë për të arritur standarde më të larta.

Qëllimi i artikullit është të identifikojë dhe të analizojë problematikat kryesore dhe sfidat që universitetet e Ballkanit Perëndimor ballafaqohen në fushën e kërkimit shkencor duke e vendosur më së shumti theksin tek Shqipëria dhe sfidat që ndeshen universitetet shqiptare.

Artikulli ka disa objektiva:

- Evidentimi i disa prej sfidave dhe vështirësive të universiteteve të Ballkanit perëndimor për kërkimin shkencor;
- Evidentimi i rolit dhe rëndësisë së institucioneve për rritjen e performancës së akademikëve;
- Evidentimi i rolit dhe rëndësia e burimeve njerëzore për rritjen e performancës institucionale;
- Përgatitja e rekomandimeve për rritjen e standardeve dhe performancës së universiteteve për kërkimin shkencor.

-
- Artikulli synon të ofrojë një përmbledhje të sfidave të cilat pengojnë përmirësimin e standardeve të kërkimit shkencor në këtë rajon.

II. METODOLOGJIA

Për realizmin e këtij artikulli, pra për të kuptuar dhe analizuar sfidat e kërkimit shkencor në universitetet e Ballkanit Perëndimor, është përdorur metoda e vëzhgimit dhe e analizës. Kjo analizë është realizuar përmes një procesi të vazhdueshëm të vëzhgimit të aktiviteteve shkencore, projekteve të kërkimit dhe ndërveprimeve në universitetet e këtij rajoni.

Vëzhgimi ka përfshirë monitorimin e botimeve akademike, infrastrukturën e kërkimit dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore. Përveç vëzhgimit të drejtpërdrejtë, analiza është bazuar në studime të mëparshme, raporte të organizatave ndërkombëtare, dokumente zyrtare të universiteteve dhe analiza akademike të publikuara. Kjo analizë ka përfshirë shqyrtimin e literaturës së disponueshme për të njohur më mirë problematikat dhe sfidat në kërkimin shkencor në këtë kontekst.

Për të mbështetur analizën, janë realizuar pyetësorë dhe biseda me përfaqësues të universiteteve, profesorë, dhe individë të përfshirë në fushën e kërkimit shkencor në këto universitete. Këta pyetësorë të realizuar gjatw implementimit të projektit “*Standards of Academic writing and scientific journal index*”², projekt individual i financuar nga Western Balkan Fund, move grant, kanë ndihmuar në përmbledhjen e pikëpamjeve të ndryshme dhe për të pasur një kuptim më të gjerë të sfidave të përcaktuara.

Informacioni i mbledhur nga këto burime është analizuar dhe interpretuar për të identifikuar trendet, shkaqet, dhe efektet e sfidave të kërkimit shkencor në universitetet e Ballkanit Perëndimor.

Pyetësori përbëhej nga dhjetë pyetje dhe i janë përgjigjur gjashtëmbëdhjetë lektorë nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës në Maqedoninë e Veriut dhe njëzetë e gjashtë lektorë nga Kolegji Universitar Reald në Shqipëri.

² Projekti është zbatuar në International University of Struga, në Struge, Maqedonia e Veriut nga Dr. Engjëllushe Zenelaj, si fituese e grantit individual nga Western Balkan Funds.

III. REZULTATE DHE DISKUTIME

Nr.	Pyetja	Alternativat	Përgjigjet	
			IUS ¹	RUC ²
1.	Si do ta vlerësoni aktualisht nivelin e kërkimit shkencor në Ballkanin Perëndimor?	a. Nivel i ultë, b. Nivel Mesatar, c. Nivel i Lartë	a. 16 b. 0 c. 0	a. 26 b. 0 c. 0
2.	Si do ti klasifikoni shkaqet e vështirësive që ndeshni në kërkimin shkencor?	a. Institucionale b. Financiare c. Teknologjike d. Tjeter_____	a. 0 b. 10 c. 6	a. 2 b. 16 c. 8
3.	Si e vlerësoni nivelin e shkëmbimeve të stafëve akademike dhe studentëve në universitetet e Ballkanit Perëndimor?	a. Nivel i ultë, b. Nivel Mesatar, c. Nivel i Lartë	a. 16 b. 0 c. 0	a. 26 b. 0 c. 0
4.	Si e vlerësoni nivelin e bashkëpunimit midis universiteteve në Ballkanin Perëndimor?	a. Nivel i ultë, b. Nivel Mesatar c. Nivel i Lartë	a. 16 b. 0 c. 0	a. 26 b. 0 c. 0
5.	Çfarë sugjeroni për rritjen e performancës së universiteteve në Ballkanin Perëndimor?	a. Hartim strategjie dhe politikash në IAL ³ b. Hartim strategjie dhe politikash në Ministrinë Arsimit c. Politika mbështetëse nga qeveritë apo organizatat d. Iniciativa të IAL-ve midis insitucioneve në Ballkanin Perëndimor	a. 3 b. 2 c. 6 d. 5	a. 6 b. 3 c. 10 d. 7
6.	A keni pasur ndonjë bashkëpunim për kërkimin shkencor me kërkues nga Ballkani perëndimor dhe cila formë?	a. PO a.1. Konferencë a.2. Botim artikulli a.3. Projekt b. JO	a. 5 b. 11	a. 10 b. 16
7.	A kishit informacion për WBF ⁴ përpara prezantimit nga kolegja juaj?	a. Po b. Jo	a. 3 b. 13	a. 2 b. 24
8.	Si do ti vlerësoni thirrjet dhe programet e WBF për	a. Të rëndësishme b. Të parëndësishme c. Shumë të rëndësishme	a. 6 b. 0 c. 10	a. 14 b. 0 c. 12

¹ IUS- International University of Struga

² RUC-Reald University College

³ IAL- Institucione të arsimit të lartë

⁴ WBF- Western Ballkan Fund

	karrierën tuaj akademike në Ballkanin Perëndimor?			
9.	A mendoni të aplikoni në thirrjet e radhës nga WBF për grante individuale apo institucionale?	a. PO b. JO c. E pavendosur	a. 8 b. 2 c. 6	a. 12 b. 3 c. 11
10.	Sa të rëndësishëm e konsideroni rritjen e bashkëpunimit midis IAL në Ballkanin perëndimor	a. Të rëndësishme b. Të parëndësishme c. Shumë të rëndësishme	a. 7 b. 0 c. 11	a. 11 b. 0 c. 15

Në përgjithësi të gjithë të anketuarit kanë vlerësuar në nivel minimal kërkimin shkencor në Ballkanin Perëndimor si dhe nivelin e shkëmbimeve të stafëve dhe studentëve. Ndër faktorët kryesorë të nivelit të ulët të kërkimit shkencor rendisin, shkaqe të ndryshme të tilla si ato financiare, teknologjike, mungesa e modernizimeve të kurrikulave, mungesa e përcaktimit të standarteve, etj.

Në përgjithësi vlerësohet si i rëndësishëm rritja e bashkëpunimit në universitetet e rajonit. Për rritjen e niveleit të bashkëpunimit në përgjithësi të anketuarit mendojnë se është e rëndësishme shtimi i politikave mbështetëse nga qeveritë dhe organizatat si dhe rritja e iniciativave nga insitucionet.

IV. SFIDAT E UNIVERSITETEVE PËR KËRKIMIN SHKENCOR NË BALLKANIN PERËNDIMOR

The Western Balkans, while facing common challenges, also exhibits considerable variation across its countries. Common challenges and priorities include: Digital skills, Green transition, Out-migration to the EU, Institutional autonomy and governance, Prevalence of secondary VET, Inequality of outcomes⁵. Rezultatet e pyetësorëve na orientojnë kërkimin drejt një analizë më të zgjeruar duke i integruar edhe me arsyetimin e studjuesve të tjerë dhe autorëve të artikullit. Në Ballkanin Perëndimor, universitetet përballen me disa sfida të tilla si:

- **Kriza demografike:** Emigrimi dhe ulja e koeficientit të lindshmërisë po reflektojnë e drejtperdrejte në numrin e studentëve në auditore. Kriza demografike është një sfidë e rëndësishme që prek universitetet në Ballkanin Perëndimor. Emigrimi i vazhdueshëm dhe zvogëlimi i popullsisë në vendet e këtij rajoni ka një impakt të drejtpërdrejtë në numrin e studentëve të regjistruar në universitete. Kjo ka ndikim në

⁵ Për më shumë shiko artikullin e LUCIA BRAJKOVIC “Education policy and development in the Western Balkans Policy & Strategy”, 7 November 2023 <https://www.eaie.org/blog/western-balkans-education-policy.html>, i cili jep një analizë të plotë statistikore me tregues shumë të rëndësishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor.

nivelin e përgjithshëm të regjistrimeve në universitete, duke ulur numrin e studentëve në auditorë. Kriza demografike sjell një kufizim në bazën potenciale të studentëve për t'u regjistruar në universitete. Ulja e popullsisë, si rezultat i emigrimit dhe faktorëve tjerë demografikë, bën që universitetet të kenë më pak aplikime dhe regjistrime në programe të ndryshme akademike dhe përveç kësaj largimi i trurit është me pasoja të drejtpërdrejta në eficienën e kërkimit shkencor. Rënia e numrit të studentëve është një efekt zinxhir në të gjitha llojet e universiteteve si ato publike edhe ato privatë. Gjatë fillim viti të ri akademik 2023-2024 në Shqipëri shumë universitete të rretheve kanë mbyllur disa prej programeve dhe disa të tjera vazhdojnë të mbeten të hapura edhe pse aty janë më pak se minimum i studentëve të lejuar nga ligji.

- **Financimi:** Mungesa e burimeve financiare është një sfidë thelbësore për universitetet në Ballkanin Perëndimor. Financimi i kufizuar mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit të ofruar, në aftësinë për të përmirësuar infrastrukturën dhe në mundësinë për të zhvilluar hulumtime të reja dhe inovative. Mungesa e burimeve financiare është një sfidë e madhe për universitetet në këtë rajon. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e arsimit dhe në aftësinë për të zhvilluar hulumtime të reja. Universitetet kanë nevojë për investime të mëdha në shkencë, teknologji, dhe resurse të tjera për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për të zhvilluar hulumtime shkencore cilësore. Mungesa e fondeve mund të çojë në një dobësi të infrastrukturës fizike, mungesë të pajisjeve të nevojshme për hulumtime laboratorike dhe informatike, si dhe mungesë të fondeve për të paguar për ekspertizën dhe asistencën nga profesorët dhe akademikët më të specializuar. Mjafton të shikojmë buxhetin e qeverive në vendet e Ballkanit Perëndimor për kërkimin shkencor dhe arsimin dhe evidentohet lehtësisht vëmendja e politikbërësve në këtë drejtim. Gjithashtu edhe vetë institucionet arsimit të lartë sidomos në Shqipëri për vite të tëra buxhetin e kërkimit shkencor e kanë në vlerë zero. Gjithashtu vërehet edhe politika diferencuese nga qeveritë midis universiteteve publike dhe jopublike, për financimin e projekteve kërkimore, duke favorizuar gjithmonë universitetet publike dhe në disa raste duke i përjashtuar universitetet jopublike⁶. Kjo politikë përjashtuese është diskriminuese pasi duhet të jetë cilësia e projekt propozimit ajo që duhet të vendosi fituesit e granteve dhe jo statusi i organizatës.

- **Cilësia e arsimit:** Për disa universitete, cilësia e arsimit ende është nën standardet e duhura, ndryshe nga universitetet e njohura në Perëndim. Mungesa e standardizimit dhe nivelit të ulët të cilësisë së arsimit në disa universitete të Ballkanit Perëndimor është një sfidë që po bëhet thelbësore për avancimin e arsimit të lartë në këtë rajon. Kjo diferencë në cilësi mund të ndikojë në reputacionin dhe aftësinë e universiteteve

⁶ Rasti i thirrjeve për projekte të financuara nga qeveria shqiptare nëpërmjet AKKSHI e cila përjashtonte universitet jopublike për pajisje teknologjike gjate vitit 2023

për të tërhequr studentë të rinj, për të mbajtur stafin akademik të kualifikuar dhe për të kontribuar në zhvillimin e hulumtimeve shkencore të cilësisë së lartë. Në krahasim me universitetet e njohura në Perëndim, universitetet në Ballkanin Perëndimor mund të kenë mungesë të resurseve të nevojshme për të ofruar një arsim të lartë cilësor. Infrastruktura e dobët, mungesa e teknologjisë së avancuar, dhe mungesa e programeve të përshtatshme studimore mund të jenë disa nga faktorët që kontribuojnë në këtë ndryshim në cilësi. Proceset e Akreditimit që po përballojnë universitetet gjatë viteve të fundit janë një hap pozitiv por ato lëvizin ngadale dhe në disa raste nuk janë realiste për plotësimin e standarteve.

- **Modernizimi i kurrikulës dhe teknologjisë:** Universitetet duhet të përditësojnë kurrikulat e tyre për të reflektuar nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin e teknologjisë. Modernizimi i kurrikulave në universitetet e Ballkanit Perëndimor është një hap i rëndësishëm drejt përshtatjes së arsimit të lartë me zhvillimet e fundit në tregun e punës dhe avancimet teknologjike. Përditësimi i kurrikulave për të reflektuar nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin teknologjik siguron që studentët të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e reja në botën e punës. Kjo përfshin përmirësimin e programeve mësimore me qëllim aftësim të studentëve për në tregun e punës dhe rritje dhe zhvillim për stafet akademike në mënyrë të vazhdueshme. Mungesa e modernizimit të kurrikulave dhe i programeve studimore si dhe i teknologjisë evidentohet tek niveli i papunësisë për të diplomuarit në fusha të caktuara të cilët nuk e gjejnë vetenplotësisht në tregun e punës.

- **Çështje të korrupsioni:** Në disa raste, korrupsioni mund të ketë ndikim në rekrutimin e stafeve akademike dhe në procesin e vlerësimit të studentëve. Korrupsioni në sektorin e arsimit është një sfidë serioze në Ballkanin Perëndimor, duke ndikuar në proceset e rekrutimit të stafit akademik⁷ dhe në vlerësimin e studentëve. Në raste të tilla, praktikatat e korrupsionit mund të prekin shumë sfera të jetës universitare dhe të dëmtojnë integritetin akademik dhe cilësinë e arsimit të ofruar. Ndikimi i korrupsionit në rekrutimin e stafit akademik mund të shkaktojë situata ku personat jo të kualifikuar ose me aftësi të kufizuara akademike mund të jenë të përparuar në poste të rëndësishme. Kjo mund të prekë cilësinë e mësimdhënies dhe hulumtimit në universitetet e prekura. Në lidhje me vlerësimin e studentëve, korrupsioni⁸ mund të sjellë situata ku studentët me performancë të dobët ose pa meritë mund të favorizohen në mënyrë të padrejtë në vlerësimet akademike. Rastet e publikuar anë media mbi korrupsionin në arsimin e lartë ndikojnë në uljen e standarteve të

⁷ Në faqet zyrtare të universiteteve publike/jopublike në shumicën e rasteve nuk gjen njoftime për pozicione vakante

⁸Rasti më i fundi në Shqipëri është ai i nodhur në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, ku ish-rektorja u pezullua nga detyra sipas urdhrit të Ministrisë së Arsimit Nr.313 Datë 22.06.2023, shkresa nr 3911 prot, datë 22.06.2023, pezullim ky që erdhi për shka të shkeljeve të rënda të zbuluara nga emisioni televiziv investigativ STOP datë 21.06.2023

cilësisë së arsimit dhe uljen e besueshmërisë. Aspektet e korrupsionit vërehen edhe në rastet e abuzimit me buxhetin e universiteteve publike. Jo të pakta janë rastet e publikuara nga institucionet e kontrollit për shkeljet dhe shpërdorimet e buxhetit të universiteteteve.⁹

- **Mobiliteti i studentëve dhe stafit:** Në krahasim me universitetet në Perëndim, shumë universitete në Ballkanin Perëndimor kanë sfida në përkrahjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik. Treguesit flasin për një nivel të ulët të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve në Ballkanin Perëndimor.


- **Bashkëpunimit ndërkombëtar:** Aktualisht në shumë universitete konstatohen marrëveshje bashkëpunimi të cilat shumicën e rasteve qëndrojnë si dokumente pa produkte konkrete. Bashkëpunimi me universitetet e tjera dhe shkëmbimi i njohurive është ende në zhvillim dhe ka hapësirë për përmirësim.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Të gjitha institucionet arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor duhet të mendojnë seriozisht dhe të marrin angazhime konkrete për sfidat që kanë përballë. Hartimi i strategjive konkrete me objektiva realë dhe të matshëm do të renditej si hapi i parë për cilindo institucion.


Më poshtë pasqyrohet në paraqitje grafike një mendim i cili është shumë esencjal. Jo pa qëllim është zgjedhur kjo mënyrë, pra për të kuptuar se universiteti dhe burimet njerëzore janë përcaktuesit e performancës në total.

Fig.1 Paraqitje ilustruese e Instrumenteve të universitetit për rritjen e performancës



⁹ Rasti i Raportit të Kontrollit të Lartë Shtetit, 2021 për auditimin në Universitetin e Tiranës, si dhe raportet publikuara nga Qëndresa Qytetare, <https://citizens-channel.com/2022/11/09/ku-shkojne-parate-e-universiteteve-miliona-per-sigurine-e-godinave-0-38-per-kerkim-shkencor/>

Fig. Nr.2, Paraqitje ilustruese e rolit të akademikëve për përmirësimin e performancës së universitetit



Në përgjithë rekomandohet që strategjia e një universiteti në Ballkanin Perëndimor duhet të përfshijë hapa të qëndrueshëm për zhvillimin dhe përballjen e sfidave të përmendura më lart. Këtu janë disa pika kyçe të një strategjie të tillë:

- **Përmirësimi i cilësisë së arsimit:** Universiteti duhet të vendosë standarde të larta për cilësinë e arsimit dhe të sigurojë se programet dhe kurrikulat janë të përditësuara për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin e teknologjisë.
- **Investimi në burime njerëzore:** Universiteti duhet të investojë në rekrutimin dhe trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për të siguruar një ekip të përkushtuar dhe të kualifikuar.
- **Diversifikimi i burimeve financiare:** Strategjia duhet të përfshijë marrëveshje me qeverinë, sektorin privat, dhe burime ndërkombëtare për të siguruar financim të mjaftueshëm. universitetet mund të shqyrtojnë opsione të ndryshme për të rritur burimet financiare. Kjo përfshin kërkimin e burimeve shtesë nga burime publike dhe private, aplikimin për fonde të projekteve shkencore në nivel ndërkombëtar, si dhe krijimin e partneriteteve strategjike me sektorin e privat dhe organizatat e ndryshme për të siguruar mbështetje financiare.

Gjithashtu, shteti mund të luajë një rol kyç në rritjen e fondeve për universitetet duke investuar më shumë në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor si një përparësi që do të rrisë cilësinë e arsimit dhe konkurrueshmërinë në nivel ndërkombëtar të universiteteve në këtë rajon.

Një politikë e qëndrueshme dhe e përshtatshme e financimit mund të ndihmojë në kapërcimin e mungesave financiare dhe të cojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu politikat dhe mundësitë e financimit nuk duhet të jenë

diskriminuose në financimin e projekteve kërkimore shkencore midis universiteteve publike dhe jopublike.

Universitetet duhet të zhvillojnë partneritete dhe marrëveshje me universitetet dhe institucionet e tjera ndërkombëtare për të rritur mobilitetin e studentëve dhe stafit, si dhe për të ndarë njohuri dhe burime.

Universitetet duhet të rrisin dhe përmirësojnë përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar eficiencën e administratës, procesit mesimor, mësimin në distancë, dhe për të zhvilluar hulumtime inovative. Gjithashtu të gjitha universitetet duhen të kenë teknologji të certifikuar nga Agjensite e Informacimit me qëllim mbrotjen e të dhënave, shmangien e abuzimeve, korrupsionit, dhe rritjen e standartit të përgjithshëm.

Universitetet duhet të kenë një rol aktiv në zgjidhjen e çështjeve sociale dhe mjedisore në komunitetin e tij. Përfshirja dhe angazhimi i universiteteve në çështjet sociale dhe mjedisore në komunitetin ku ata janë të vendosur është thelbësore për të ndikuar në ndryshimet pozitive në komunitetin e tyre dhe për të përgatitur studentët për një rol të përgjegjshëm shoqëror dhe mjedisor.

Disa mënyra në të cilat universitetet mund të zbatojnë përgjegjësinë e tyre sociale dhe mjedisore janë në saj të rritjes së bashkëpunimit me aktorët rajonal dhe lokal. Përmes angazhimit të tyre, universitetet bëhen një forcë pozitive në shoqëri, duke kontribuar në zhvillimin e një brezi të ri, që janë të përgatitur për të kontribuar në ndryshime pozitive shoqërore dhe për të mbrojtur mjedisin në të cilin jetojnë.


Universiteti duhet të ketë sisteme të qarta për të monitoruar dhe vlerësuar performancën në përputhje me objektivat e tij strategjike. Sistemet e monitorimit dhe vlerësimit të performancës janë esenciale për universitetet për të siguruar se po përmbushin objektivat e tyre strategjike dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve dhe programeve të tyre. Disa hapa që universitetet mund të ndërmarrin për të zhvilluar këto sisteme lidhen me percaktimin e objektivave, realizimin e tyre dhe vlerësimin për përmirësimin e vazhdueshëm.

Në lidhje me sfidën demografike universitetet mund të gjejnë mënyra inovative për të tërhequr studentë të rinj, përmes ofrimit të programeve të atraktivë, bashkëpunimit me industrinë dhe organizatat e ndryshme për të siguruar mundësi të punësimit pas përfundimit të studimeve, si dhe promovimin e arsimit të lartë në nivele më të gjerë, duke siguruar qasje më të lehtë në programe të specializuara.

Gjithashtu, investimet në strategji për të ruajtur talentin vendas dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit mund të ndihmojnë në mbajtjen e studentëve në vend dhe në rritjen e numrit të tyre në universitete. Krijimi i programeve të ndihmës financiare, bursave dhe mundësive të mbështetjes për studentët nga grupet me vështirësi ekonomike mund të

jenë një mënyrë për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe përfundimin e studimeve për këtë grup.

Fig. Nr.3, Paraqitje ilustruese e logjikës së Performancës së universiteteve



Një strategji e tillë e përgatitur dhe zbatuar me kujdes mund të ndihmojë një universitet në Ballkanin Perëndimor të zhvillohet dhe të përballojë sfidat me sukses.

Për të adresuar këto sfida, është e rëndësishme të ketë një përkushtim të përbashkët për të ndërtuar kapacitetet e kërkimit shkencor, për të përmirësuar infrastrukturën, për të shtuar financimin dhe për të zhvilluar platforma të ndryshme për bashkëpunim ndërmjet universiteteve.

Investimi në teknologji, burime njerëzore të trajnuara dhe ngritja e standardeve akademike mund të ndihmojnë në përmirësimin e kërkimit shkencor dhe në rritjen e cilësisë së botimeve në nivel ndërkombëtar.

Krijimi i programeve dhe projekteve të përbashkëta për bashkëpunim akademik, si dhe promovimi i shkëmbimit të njohurive dhe ideve nëpërmjet aktiviteteve akademike mund të ndihmojë në përmirësimin e situatës dhe në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në Ballkanin Perëndimor.

REFERENCA & LITERATURË MBESHTETËSE

1. Buletini Shkencor Reald, "REGULATIONS FOR THE ORGANIZATION AND OPERATION OF THE BULETINI SHKENCOR REALD & MANUSCRIPT

SUBMISSION GUIDELINES” 2022, https://unireald.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Author_guidlines_Buletini_Reald.pdf

2. Buletini Shkencor Reald, “REGULATIONS FOR THE ORGANIZATION AND OPERATION OF THE BULETINI SHKENCOR REALD & MANUSCRIPT SUBMISSION GUIDELINES” 2022, https://unireald.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Author_guidlines_Buletini_Reald.pdf

3. Cenerić I., Ayan M., Todorović M. , Marković J.Č., “ARISE Action for Reducing Inequalities in Education Comparative report for Albania, Bosnia and Herzegovina, North Macedonia, Kosovo, Serbia and Turkey”, Centre for Education Policy, Carigradska 21/20, Belgradecep@cep.edu.rs , www.cep.edu.rs

4. DANIEL ANDERSEN, “The internationalization deficit of research and higher education in the western Balkans A CASE STUDY OF THE REGION”, Utrecht University, 06.07.2018 Irish-Dutch Double Degree University College Dublin/Utrecht University

5. <https://citizens-channel.com/2022/11/09/ku-shkojne-parate-e-universiteteve-miliona-per-sigurine-e-godinave-0-38-per-kerkim-shkencor/>

6. https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/edat_ifse_03/default/table?lang=en

7. https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_education_statistics#Number_of_pupils_and_students

8. https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_education_statistics#Tertiary_education Data extracted in May 2023. Planned article update: June 2024

9. Kajsio Blendi, “*Higher Education in Albania: The Never Ending Challenge*”, INTERNATIONAL HIGHER EDUCATION 15, Number 82: Fall 2015

10. KOLEGJI UNIVERSITAR “REALD” STRATEGJI ZHVILLIMI (2021 – 2026), (Miratuar me Vendim nr. 6, datë 02.06.2020, të Bordit të Administrimit), <https://unireald.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/3.-Stratgjia-e-Zhvillimit-Institucional-2021-2026-1.pdf>

11. LUCIA BRAJKOVIC “*Education policy and development in the Western Balkans Policy & Strategy*”, 7 November 2023 <https://www.eaie.org/blog/western-balkans-education-policy.html>

12. Sabriu, Miranda (2013): “The European Perspective of the Four Western Balkan Countries” International Journal of Academic Research in Business and Social Sciences December 2013, Vol. 3, No. 12, pp. 432 -445,

13. Urdher-Nr.36-date-24.1.2023 e Ministrisë së Arsimit “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË REVISTAVE SHKENCORE QË BOTOHEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Urdher-Nr.36-date-24.1.2023-Pdf.pdf>

14. Urdhrit të Ministrisë së Arsimit, Nr.313 Datë 22.06.2023, shkresa me nr.3911 prot, datë 22.06.2023, “Për pezullimin nga detyra të Rektores së Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër

15. Zenelaj E., “*Challenges of Albanian System Education in Systematic Integration of Technology and Education*”, Global Smart Education Conference 2022 Digital Literacy and Smart Learning Forum, Published in 2023 by Smart Learning Institute of Beijing Normal University, 12th Floor, Block A of Jingshi Science and Technology Building, No. 12 Xueyuan South Road, Haidian District, Beijing© Smart Learning Institute of Beijing Normal University 2023 ,
http://sli.bnu.edu.cn/en/Download/Promotional/Research_Report/2023/0321/2821.html

16. Zgaga, Pavel (2013): “Reconsidering Higher Education Reforms in the Eastern Balkans: ‘Policy Colonies’ or ‘Policy Autarchies’?” in Zgaga, Pavel; Teichler, Ulrich; Brennan John (editors): Globalisation Challenge for European Higher Education: Convergence and Diversity, Centres and Peripheries, pp. 347-370

17. Zhllima E., Imami D., Rama K., Shahini A., “*Corruption in Education during Socialism and the Postsocialist Transition: The Case of Albania*”, Region: Regional Studies of Russia, Eastern Europe, and Central Asia, Volume7, Number 2, July 2018, pp. 51-70 (Article)Published by Slavica Publishers, DOI:For additional information about this article, Access provided at 29 Mar 2019 17:17 GMT from Idaho State University,
<https://doi.org/10.1353/reg.2018.0016>, <https://muse.jhu.edu/article/707823>